

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP  
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ**



**УНИВЕРЗИТЕТСКИ ГЛАСНИК  
INFORMATORI UNIVERSITAR**

**Nr.17-1/2026 / Бр.17-1/2026**

**Shkup, Janar 2026  
Скопје, Јануари 2026 година**

**Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**  
**Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје**

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:  
Prof. Dr. Bekim Fetaji, rektor / Проф. д-р Беким Фетаји, ректор

Redaktor i Informatorit / Уредник на гласникот:  
Prof. Dr. Mustafa Ibrahimimi / Проф. д-р Мустафа Ибрахими  
Mr. Vujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

Këshilli redaktues / Уредувачки одбор:  
Prof. Dr. Mustafa Ibrahimimi / Проф. д-р Мустафа Ибрахими  
Prof. Inor. Dr. Fati Iseni / Вонр. Проф. д-р Фати Исени  
Dr. Raim Jashari / Д-р Раим Јашари  
Mr. Vujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

Rregullimi teknik / Техничко уредување  
Mr. Vujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

## **PËRMBAJTJA/SOДРЖИНА**

1. Програма за работа на кандидатот за декан на Факултетот за социјални науки вонр. проф. д-р Бејтула Емини / Programi i punës i kandidatit për dekan të Fakultetit të Shkencave Sociale Prof. Inor. Dr. Bejtulla Emini -----

# Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup

## Fakulteti i Shkencave Sociale



### **PROGRAM I PUNËS** **i Kandidatit për Dekan**

**Mandati: 2026–2029**

**Kandidati për Dekan: Assoc. Prof. Dr.sc. Bejtulla Emini**

Janar 2026

## Përmbajtja

<b>HYRJE</b> .....	<b>6</b>
<b>II. VIZIONI DHE PARIMET UDHËHEQËSE</b> .....	<b>8</b>
<b>III. PRIORITETET STRATEGJIKE TË MANDATIT</b> .....	<b>9</b>
<b>IV. PROGRAMI OPERACIONAL SIPAS FUSHAVE STRATEGJIKE</b> .....	<b>10</b>
1. Përmirësimi i mësimdhënies dhe organizimit të procesit mësimor .....	10
2. Studimi dhe zhvillimi i programeve studimore .....	10
3. Fuqizimi i kërkimit shkencor dhe projekteve .....	10
4. Roli i studentit dhe jeta akademike .....	11
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	11
6. Partneriteti publik–privat dhe shoqëror.....	11
7. Qeverisja, transparenca dhe menaxhimi .....	12
8. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore akademike.....	12
9. Rritja e efikasitetit të administratës së Fakultetit.....	12
10. Nxitja e raporteve ndërkolegjiale dhe kulturës akademike bashkëpunuese .....	13
<b>PËRFUNDIM</b> .....	<b>14</b>

## HYRJE

Duke u nisur nga roli strategjik i Fakultetit të Shkencave Sociale në kuadër të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i cili përfaqëson pothuajse gjysmën e kapacitetit akademik dhe programor të Universitetit, ky program pune synon forcimin e cilësisë akademike, rritjen e ndikimit shkencor dhe konsolidimin e rolit publik të Fakultetit si shtyllë qendrore e zhvillimit universitar, shoqëror dhe institucional.

Fakulteti i Shkencave Sociale karakterizohet nga një laramani dhe gjerësi e programeve studimore, të cilat mbulojnë fusha thelbësore të zhvillimit njerëzor, shoqëror, institucional dhe politik. Kjo e bën Fakultetin jo vetëm njësinë më të madhe akademike në kuadër të Universitetit, por edhe bartësin kryesor të misionit publik të universitetit në raport me shoqërinë.

Në kuadër të këtij Fakulteti zhvillohen programe studimore me peshë strategjike, si:

- **Punë dhe Politikë Sociale**, program i orientuar drejt analizës së politikave sociale, mbrojtjes sociale, punësimit dhe përfshirjes sociale
- **Sport dhe Shkenca Sportive**, program që përfaqëson një ndërthurje të edukimit fizik, shëndetit publik, performancës sportive dhe shkencave aplikative, duke kontribuar drejtpërdrejt në mirëqenien shoqërore dhe formimin profesional të kuadrove në fushën e sportit dhe aktivitetit fizik;
- **Media dhe Komunikim Ndërkulturor**, i cili luan rol kyç në ndërtimin e dialogut ndërkulturor, komunikimit publik dhe etikës mediatike në një shoqëri multietnike;
- **Psikologji**, si disiplinë bazë për shëndetin mendor, edukimin, zhvillimin personal dhe mirëqenien sociale;
- **Administratë Publike**, program i fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve profesionale për menaxhimin publik, qeverisjen dhe shërbimet publike;
- **Studime Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare**, program themelor për analizën e sistemeve politike, demokracisë, politikëbërjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Kjo strukturë multidisiplinare e Fakultetit të Shkencave Sociale e pozicionon atë si një platformë unike të prodhimit të dijes kritike, analizës shkencore dhe formimit profesional të kuadrove që do të vepronë në administratë publike, arsim, siguri, diplomaci, shoqëri civile dhe sektorë të tjerë me rëndësi strategjike për shtetin dhe rajonin. Në këtë kontekst, programi i punës i kandidatit për dekan synon jo vetëm administrimin efikas të një strukture kaq komplekse dhe të gjerë, por edhe udhëheqjen akademike vizionare të Fakultetit, duke forcuar kohezionin ndërmjet programeve studimore dhe identitetin e përbashkët akademik.

Programi bazohet në tre shtyllat themelore të veprimtarisë universitare:

- Veprimtaria mësimore-edukative, me fokus në cilësi, gjithëpërfshirje, mendim kritik dhe lidhje të drejtpërdrejtë me praktikën;
- Veprimtaria shkencore-hulumtuese, e orientuar drejt kërkimit empirik, analizës teorike dhe publikimeve me relevancë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Veprimtaria profesionale dhe aplikative, në shërbim të institucioneve publike, komunitetit akademik dhe shoqërisë në tërësi.

Zbatimi i këtij programi do të mbështetet në parimet e qeverisjes së mirë universitare, transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit kolegjal ndërmjet stafit akademik, studentëve dhe strukturave drejtuese të Universitetit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërtimit të një klime akademike të hapur, etike dhe motivuese, ku cilësia dhe integriteti akademik përbëjnë standard themelor.

Të gjitha aktivitetet dhe politikat e parashikuara në këtë program do të jenë në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit “Nënë Tereza”, parimet e Procesit të Bolonjës, si dhe standardet dhe rekomandimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), me synim pozicionimin e Fakultetit të Shkencave Sociale si një njësi akademike moderne, konkurruese dhe e respektuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## II. VIZIONI DHE PARIMET UDHËHEQËSE

Vizioni i këtij programi është zhvillimi i Fakultetit të Shkencave Sociale si një njësi akademike e konsoliduar, moderne dhe konkurruese, e cila jo vetëm garanton cilësi të lartë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, por ushtron edhe një rol aktiv dhe të përgjegjshëm në jetën shoqërore, institucionale dhe publike. Ky vizion bazohet në bindjen se Fakulteti duhet të funksionojë si hapësirë e mendimit kritik, dialogut akademik dhe prodhimit të dijes me vlerë reale për shoqërinë.

Në këtë kuptim, Fakulteti i Shkencave Sociale synon të forcojë identitetin e tij akademik brenda Universitetit “Nënë Tereza”, duke ndërtuar kohezion ndërmjet programeve studimore, duke rritur ndikimin shkencor të stafit akademik dhe duke përgatitur kuadro profesionale të afta për t’u përballur me sfidat komplekse të zhvillimit shoqëror, politik dhe institucional.

Realizimi i këtij vizioni mbështetet në disa parime themelore udhëheqëse, të cilat do të orientojnë të gjitha politikatat dhe veprimet gjatë mandatit 2026–2029:

- **Qeverisja e mirë universitare**, e bazuar në respektimin rigoroz të Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit dhe procedurave akademike, si garanci për stabilitet institucional, vendimmarrje të përgjegjshme dhe funksionim efikas të Fakultetit.
- **Transparenca dhe llogaridhënia**, si parime thelbësore për ndërtimin e besimit institucional, përmes informimit të rregullt të stafit akademik dhe studentëve, si dhe përmes raportimit të qartë mbi vendimet, prioritetet dhe rezultatet e punës të fakultetit.
- **Meritokracia akademike**, e cila nënkupton vlerësimin objektiv të punës mësimore, shkencore dhe profesionale të stafit akademik, avancimin mbi bazë të kriterëve të qarta dhe krijimin e një klime ku cilësia dhe integriteti akademik shpërblehen.
- **Bashkëpunimi kolegjal**, si themel i një kulture akademike të shëndoshë, ku respektohet dinjiteti profesional, inkurajohet puna ekipore ndërmjet katedrave dhe programeve studimore dhe promovohet dialogu i hapur akademik.
- **Përfshirja aktive e studentëve në jetën akademike**, duke i trajtuar ata jo vetëm si përfitues të procesit mësimor, por si partnerë të barabartë në zhvillimin e Fakultetit, në proceset vendimmarrëse, aktivitetet shkencore dhe angazhimin shoqëror.

Këto parime përbëjnë boshtin normativ dhe etik të këtij programi pune dhe do të shërbejnë si udhërrëfyes për të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara.

### III. PRIORITETET STRATEGJIKE TË MANDATIT

Prioritetet strategjike të mandatit 2026–2029 burojnë drejtpërdrejt nga struktura, misioni dhe përgjegjësitë publike të Fakultetit të Shkencave Sociale, si dhe nga kompetencat statutorë të dekanit në kuadër të universitetit të integruar. Këto prioritete nuk paraqesin qëllime abstrakte, por orientime të qarta veprimi që synojnë stabilitet institucional, cilësi akademike dhe ndikim shoqëror të matshëm.

Në këtë kontekst, programi strukturohet rreth pesë boshteve strategjike kryesore:

- Mbështetja dhe motivimi i stafit akademik

Stafi akademik përbën kapitalin themelor të Fakultetit. Prioritet strategjik i këtij mandati do të jetë krijimi i një klime akademike motivuese dhe meritokratike, ku zhvillimi profesional, kërkimi shkencor dhe angazhimi institucional vlerësohen dhe mbështeten në mënyrë të drejtë dhe transparente. Kjo nënkupton mbrojtjen e dinjitetit akademik, respektimin e lirisë akademike dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet katedrave dhe programeve studimore.

- Menaxhimi efikas dhe transparenca institucionale

Qeverisja e Fakultetit do të orientohet drejt funksionimit efikas, respektimit rigoroz të procedurave statutorë dhe forcimit të transparencës në vendimmarrje. Ky bosht synon rritjen e besimit institucional përmes informimit të rregullt të stafit dhe studentëve, koordinimit konstruktiv me Rektoratin dhe menaxhimin racional të burimeve njerëzore dhe organizative.

- Studentët si partnerë aktivë të jetës akademike

Studentët do të trajtohen si subjekt aktiv i jetës akademike dhe jo vetëm si përfitues të procesit mësimor. Prioritet i veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse, aktivitetet shkencore, praktikat profesionale dhe iniciativat jashtëkurrikulare, me qëllim formimin e kuadrove të përgatitura profesionalisht.

- Bashkëpunimi me institucionet dhe komunitetin

Fakulteti i Shkencave Sociale ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë publike ndaj shoqërisë. Ky bosht strategjik synon forcimin e lidhjes ndërmjet dijes akademike dhe nevojave reale shoqërore, përmes bashkëpunimit me institucione shtetërore, pushtetin lokal, organizata të shoqërisë civile dhe sektorin privat, duke e pozicionuar Fakultetin si partner të besueshëm institucional.

- Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Shkencave Sociale

Ndërkombëtarizimi trajtohet si prioritet transversal që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit profesional. Ky bosht synon zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, rritjen e mobilitetit akademik dhe integrimin e Fakultetit në rrjete evropiane të arsimit dhe kërkimit shkencor.

Këto pesë boshte përbëjnë kornizën strategjike të programit të punës dhe shërbejnë si bazë orientuese për masat konkrete dhe veprimet operative që shtjellohen në kapitujt vijues.

## **IV. PROGRAMI OPERACIONAL SIPAS FUSHAVE STRATEGJIKE**

### **1. Përmirësimi i mësimdhënies dhe organizimit të procesit mësimor**

Përmirësimi i mësimdhënies përbën prioritet qendror të veprimtarisë akademike të Fakultetit. Në këtë drejtim, fokusi do të vendoset në rritjen e cilësisë së procesit mësimor përmes zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të orientuara drejt studentit dhe zhvillimit të mendimit kritik. Do të inkurajohet përdorimi i qasjeve interaktive si studimet e rasteve, puna në grupe, debatet akademike dhe lidhja e teorisë me praktikën.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet standardizimit dhe transparencës së vlerësimit të studentëve, duke zbatuar kriteret e qarta dhe të njëjta për të gjitha programet studimore. Do të nxihet digjitalizimin e procesit mësimor, përmes shfrytëzimit funksional të platformave universitare, Classroom si dhe NotebookLM for Teachers, që do të shërbejnë si mjet për rritjen e efikasitetit dhe qasjes në përmbajtje mësimore. Po ashtu, do të artikulohej në mënyrë të vazhdueshme nevojat për përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe organizimin sistematik të praktikës profesionale.

### **2. Studimi dhe zhvillimi i programeve studimore**

Zhvillimi i programeve studimore do të udhëhiqet nga parimi i cilësisë akademike dhe relevancës shoqërore. Do të realizohet analizë periodike e programeve ekzistuese, me qëllim përditësimin e kurrikulave dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore shkencore.

Një dimension i rëndësishëm është zhvillimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i të gjitha programeve studimore brenda Fakultetit të shkencave sociale. Fokus i veçantë do t'i kushtohet përditësimit të programeve ekzistuese, rritjes së koherencës ndërmjet cikleve të studimit dhe krijimit të bazës institucionale për avancime të qëndrueshme akademike. Paralelisht, do të inkurajohet zhvillimi i programeve ndërdisiplinare dhe forcimi i studimeve të ciklit të dytë (Master), përmes një organizimi më efikas akademik, koordinimi të qartë programor dhe rritjes së cilësisë mësimore dhe kërkimore.

### **3. Fuqizimi i kërkimit shkencor dhe projekteve**

Kërkimi shkencor do të trajtohet si shtyllë themelore e zhvillimit akademik të Fakultetit. Do të krijohen kushte nxitëse për rritjen e produktivitetit shkencor të stafit akademik, përmes mbështetjes për publikime në revista shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fakulteti do të inkurajojë aplikimin në projekte kërkimore dhe zhvillimin e grupeve kërkimore sipas fushave studimore. Studentët e ciklit Master, do të përfshihen në mënyrë aktive në aktivitete kërkimore duke inkurajuar për publikime në revistat tona shkencore si TDS dhe Migracioni në bashkëpunim me profesorët, në këtë mënyrë forcohen lidhjet ndërmjet mësimdhënësit, studentëve dhe kërkimit shkencor.

#### **4. Roli i studentit dhe jeta akademike**

Studentët do të jenë në qendër të politikave zhvillimore të Fakultetit, jo vetëm si përfitues të procesit mësimor, por si pjesëmarrës aktivë në jetën akademike dhe institucionale. Do të mbështetet funksionimi real dhe i vazhdueshëm i përfaqësimit studentor, duke siguruar përfshirjen e studentëve në diskutime, iniciativa dhe aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e studimeve dhe jetën akademike.

Përfshirja e studentëve do të konkretizohet përmes organizimit të konferencave studentore, forumeve tematike, punëtorive praktike dhe aktiviteteve të ndryshme, ku ata do të kenë mundësi të prezantojnë punime, ide dhe projekte në bashkëpunim me stafin akademik. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i praktikës profesionale do të trajtohet si komponent i rëndësishëm i formimit akademik, përmes mekanizmave institucionalë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private.

Forcimi i lidhjes me tregun e punës do të synojë pajisjen e studentëve me kompetenca praktike dhe përvojë konkrete profesionale, ndërsa krijimi i mundësive për mobilitet studentor, përmes programeve ndërkombëtare dhe shkëmbimeve akademike Erasmus + etj., të cilat do të shërbejnë si mjet për zgjerimin e horizontit akademik, profesional dhe kulturor të studentëve.

#### **5. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Bashkëpunimi ndërkombëtar do të trajtohet si instrument konkret për rritjen e cilësisë akademike dhe forcimin e profilit ndërkombëtar të Fakultetit. Në këtë drejtim, do të punohet në aktivizimin real të marrëveshjeve ekzistuese, duke kaluar nga bashkëpunimi formal në bashkëpunim funksional, si dhe në krijimin e partneriteteve të reja me universitete rajonale dhe evropiane që ofrojnë përputhshmëri akademike dhe interes të ndërsjellë.

Fokusi praktik do të vendoset në rritjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve përmes programeve ndërkombëtare të shkëmbimit, veçanërisht Erasmus+, si dhe në përfshirjen e tyre në ligjërata të përbashkëta, shkolla verore, seminare dhe konferenca ndërkombëtare. Po ashtu, do të inkurajohet zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe akademike, me qëllim shkëmbimin e përvojave, ngritjen e standardeve akademike dhe rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të Fakultetit.

#### **6. Partneriteti publik–privat dhe shoqëror**

Fakulteti do të zhvillojë bashkëpunim të strukturuar dhe të qëndrueshëm me institucione publike, pushtetin lokal, sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim që dija akademike dhe ekspertiza profesionale e Fakultetit të lidhen drejtpërdrejt me nevojat reale shoqërore dhe institucionale. Ky bashkëpunim do të konkretizohet përmes marrëveshjeve formale dhe mekanizmave funksionalë që mundësojnë realizimin e projekteve aplikative, studimeve dhe analizave të orientuara drejt politikëbërjes publike, zhvillimit social dhe përmirësimit të shërbimeve publike.

Në këtë kuadër, partneritetet do të shërbejnë si bazë për organizimin e praktikave profesionale të studentëve, përfshirjen e tyre në projekte konkrete në terren, si dhe për ofrimin e konsulencës shkencore dhe profesionale nga stafi akademik i Fakultetit. Përmes

këtyre formave të bashkëpunimit synohet rritja e relevancës shoqërore të programeve studimore, forcimi i kompetencave praktike të studentëve dhe pozicionimi i Fakultetit si aktor aktiv dhe i besueshëm në zhvillimin institucional dhe shoqëror.

## **7. Qeverisja, transparenca dhe menaxhimi**

Qeverisja e Fakultetit do të zhvillohet mbi bazën e transparencës, llogaridhënies dhe respektimit të plotë të procedurave statutore, përmes një organizimi të qartë dhe funksional të vendimmarrjes institucionale. Vendimet kryesore akademike, organizative dhe zhvillimore do të merren përmes organeve kompetente të Fakultetit, në përputhje me Statutin dhe aktet nënligjore, duke siguruar përfshirje dhe informim të rregullt të stafit akademik dhe studentëve.

Në praktikë, transparenca do të realizohet përmes komunikimit të vazhdueshëm institucional, publikimit të vendimeve dhe njoftimeve relevante, si dhe mbajtjes së takimeve të rregullta të organeve akademike, ku do të diskutohen çështje me rëndësi për funksionimin e Fakultetit. Llogaridhënia do të sigurohet përmes raportimit periodik mbi aktivitetet e realizuara, vendimet e marra dhe rezultatet e arritura gjatë mandatit.

Monitorimi i realizimit të programit të punës do të zbatohet në mënyrë periodike, përmes vlerësimit të progresit sipas objektivave të përcaktuara dhe analizës së zbatimit të masave konkrete. Në bazë të këtyre vlerësimeve, do të ndërmerren hapa korrigjues dhe do të përshtaten politikat dhe veprimet e Fakultetit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes dhe efikasitetit institucional.

## **8. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore akademike**

Zhvillimi i stafit akademik do të trajtohet si proces i planifikuar dhe i matshëm, i lidhur drejtpërdrejt me nevojat reale të programeve studimore dhe zhvillimin afatmesëm të Fakultetit. Në këtë drejtim, do të mbështetet avancimi profesional i stafit ekzistues përmes mentorimit akademik, përfshirjes sistematike në projekte kërkimore, mbështetjes për publikime shkencore dhe pjesëmarrjes në trajnime profesionale dhe akademike.

Paralelisht, do të inkurajohen angazhime të reja akademike në fusha deficitare ose në programe me rritje të numrit të studentëve, në përputhje me kriteret ligjore dhe procedurat statutore. Planifikimi i burimeve njerëzore do të bazohet në analiza konkrete të ngarkesës mësimore dhe nevojave programore, me qëllim shmangien e mbingarkesës dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie.

Balanca ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe angazhimit institucional do të realizohet përmes shpërndarjes së drejtë të ngarkesës mësimore, njohjes institucionale të aktivitetit kërkimor dhe përfshirjes së planifikuar të stafit në detyra administrative, duke krijuar kushte reale për zhvillim profesional dhe efikasitet institucional.

## **9. Rritja e efikasitetit të administratës së Fakultetit**

Administrata e Fakultetit do të funksionalizohet si shërbim mbështetës profesional dhe efikas për stafin akademik dhe studentët, me fokus të qartë në shpejtësinë, saktësinë dhe transparencën e shërbimeve. Në këtë drejtim, do të riorganizohen proceset administrative

duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e stafit administrativ dhe rrjedhën e procedurave, me qëllim shmangien e vonesave dhe mbivendosjeve funksionale.

Do të nxisim digjitalizimin e proceseve administrative i cili do të zbatohet përmes përdorimit sistematik të platformave universitare për paraqitjen e kërkesave studentore, lëshimin e vërtetimeve, komunikimin administratë–student dhe administratë–staf akademik, si dhe ndjekjen elektronike të procedurave akademike. Kjo do të mundësojë reduktimin e procedurave fizike, rritjen e transparencës dhe qasje më të lehtë në shërbime.

Po ashtu, do të organizohen trajnime periodike për stafin administrativ në fushën e menaxhimit universitar, komunikimit institucional dhe etikës profesionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ndërtimin e një kulture bashkëpunimi ndërmjet administratës, stafit akademik dhe studentëve.

## **10. Nxitja e raporteve ndërkolegjiale dhe kulturës akademike bashkëpunuese**

Krijimi i një klime akademike pozitive do të mbështetet në veprime konkrete që nxisin bashkëpunimin profesional, komunikimin e rregullt dhe ndërtimin e besimit ndërmjet stafit akademik. Në këtë drejtim, do të organizohen takime periodike kolegjiale, si formale ashtu edhe joformale, me qëllim diskutimin e çështjeve akademike, shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet katedrave dhe programeve studimore.

Aktivitetet akademike të përbashkëta, si ligjërata të hapura, tryeza diskutimi dhe punëtori shkencore, do të shërbejnë për nxitjen e dialogut akademik dhe ndarjen e përvojave profesionale. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet identifikimit dhe krijimit të mundësive për organizimin e ekspeditave akademike dhe shkencore për stafin akademik, të orientuara drejt hulumtimeve në terren, vizitave studimore në institucione dhe qendra kërkimore, si dhe bashkëpunimit me universitete dhe institute brenda dhe jashtë vendit.

Këto ekspedita dhe vizita studimore me karakter akademik dhe kërkimor do të shërbejnë për forcimin e kohezionit institucional, zhvillimin e projekteve të përbashkëta shkencore, rritjen e mirëqenies akademike dhe ndërtimin e një identiteti të përbashkët akademik të Fakultetit, duke e shndërruar bashkëpunimin kolegjial në praktikë të vazhdueshme dhe të zbatueshme.

## PËRFUNDIM

Ky program paraqet një plan të qartë, të zbatueshëm dhe të matshëm për zhvillimin e Fakultetit të Shkencave Sociale gjatë mandatit 2026–2029. Ai synon përmirësimin konkret të cilësisë së mësimdhënies, forcimin e kërkimit shkencor, rritjen e efikasitetit të qeverisjes dhe administrimit, si dhe thellimin e rolit publik dhe shoqëror të Fakultetit.

Zbatimi i programit do të realizohet përmes veprimeve të strukturuar: rishikimit dhe zhvillimit të programeve studimore, mbështetjes së qëndrueshme të stafit akademik, përfshirjes aktive të studentëve në jetën akademike, funksionalizimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe ndërtimit të partneriteteve reale me institucionet publike, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Realizimi i këtyre objektivave kërkon angazhim të përbashkët të stafit akademik, studentëve dhe strukturave drejtuese, dialog të vazhdueshëm dhe përgjegjësi profesionale në çdo nivel. Përmes monitorimit periodik të rezultateve dhe përshtatjes së masave sipas nevojës, Fakulteti do të synojë përmirësim të vazhdueshëm dhe stabilitet institucional.

Qëllimi përfundimtar i këtij programi është ndërtimi i një Fakulteti funksional, të besueshëm dhe të respektuar, i cili prodhon dije cilësore, formon kuadro të përgatitura profesionalisht dhe ushtron ndikim real në zhvillimin shoqëror dhe institucional, në përputhje me misionin e Universitetit “Nënë Tereza”.

Me respekt,

Assoc. Prof. Dr.sc. Bejtulla Emini d.v.